



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 30. 07. 2020, në sallën e kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Hyra Bytyçi, anëtare
5. Naim Jahiri, anëtar
6. Naim Stullca, anëtar
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Fatime Krasniqi, anëtare
10. Arif Miftari, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Lulzim Rustemi, anëtar
13. Ramiz Qeriqi, anëtar
14. Argjent Tasholli, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi-Hasani
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Arben Salihu, anëtar
30. Fehmi Rexhepi, anëtar

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Naser Bytyqi.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje, prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit. Pastaj

shprehi ngushëllime për të vdekurit dhe uroj shërim të shpejt për të prekurit nga covid 19, uroi për festën e Bajramit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Lulzim Rustemi, përshëndeti të pranishmit dhe uroj shërim sa më të shpejt për të prekurit nga virusi. Propozoj që në rend të ditës të jetë edhe një pikë rreth gjendjes në Komunën tonë lidhur me pandeminë

Fauz Xhenajli, përshëndeti të pranishmit, ju uroj festën e Bajramit dhe ngushëlloj për humbjet nga covid 19. Sa i përket kërkesës për pikë shtesë të rendit të ditës për gjendjen në komunë lidhur me pandeminë ne informojmë vazhdimisht për gjendjen dhe situatën me pandeminë. Më vjen keq numri i të prekurve me këtë virus në Komunën tonë ka kaluar shifren 170. Por më vjen keq në këtë mbledhje nuk mundemi me raportu meqë nuk kemi shenime të detajuara përveç këtyre të përditëshmeve që i ndëgjoni edhe ju përmes mjeteve të informimit. Kërkoj që një raport të tillë t'ju paraqesim në seancë të ardhshme.

Albulena Kelmendi, uroj që të jeni mirë me shëndet, nuk pajtohem me atë që tha Nënkryetari sepse është dashtë që në secilën seancë të na ofrohen informata lidhur me gjendjen me virus, unë kam kërku që nga DKA-ja të ketë një raport për ecurinë e seancave të mësimi të mbajtura onlajn dhe rreth përfundimit të vitit shkollor. Këtë dashtë me ngritë si çështje.

Lulzim Rustemi, në qfarë gjendje jemi është përgjegjësi e drejtoreshës për shëndetësi të jetë prezent dhe të kemi raport në gjdo seancë sepse kjo është prioritet për të gjithë. Unë jam për një raport në një seancë të jashtëzakonshme por edhe për seancë të sotme.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, unë i kam ftuar vetëm drejtorët që kanë pika të rendit të ditës për shkak të nevojës për mbajtjen e distancës së nevojshme, ju mund të bëni pyetje. Nuk është që nuk është raportuar pothuajse nëpër qdo seancë çështja e covidit. Në seancë e fundit ka qenë prezent drejtoresha e shëndetësisë dhe nuk është bërë asnjë pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Ramiz Qeriqi, edhe unë jam në përkrahje të Lulzim Rustemit, që të ketë pikë të rendit të ditës, për këtë çështje.

Fauz Xhemajli, kuvendarët mund të thirrën mbledhje të jashtëzakonshme por unë po them se Informata ka dhe ju i dini ato informata. Të gjithë kemi informata dhe se për qdo ditë po ka ndryshime. Instituti Kombëtar gjdo 3 ditë i plotëson rekomandimet prandaj për neve po është e nevojshme që të i përshtatemi situatës me gjendjen.

Kryesuesi, vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 9 vota kundër dhe 3 apstenime aprovoi rendin e ditës.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2020.
3. Propozim vendim për vënien në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2020-2028.
4. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës
5. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.

6. Propozim vendim për trajtimin e parceles kadastrale P-71409044-01745-0 në procesin e shqyrtimit publik dhe finalizimin të dokumentit të ardhshëm të planifikimit hapsinor Harta Zonale e Komunës së Lipjanit.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit

Shkëlzen Bislimi, deklaratën të cilën e keni votuar në seancën e kaluar ka pasur efektin e vetë. Pyetja ime është sa i keni kontaktuar ata që janë të infektuarë sepse ata po ankohen që po duhet vet të furnizohen me gjëra të nevojshme.

Ukë Kryeziu, unë do të vazhdoj me kërkesat e mia për shëndetësi. Meqë nuk u përfshi si pikë e veçantë e rendit të ditës do të shfrytëzoj kohën dhe mundësinë time për diskutim dhe kërkesat e mia. Për të prekurit me virus pagesat duhet të ndërprehen, participimi i tyre të hiqet, shtimi i personelit shëndetësor sepse gjendja nuk është e mirë si dhe pagesa shtesë për vikende dhe për punë jashtë orarit. Të shtohet numri i personelit shëndetësor si në mjek ashtu edhe në staf tjetër shëndetësor.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, një taksë komunale që ka qenë është hjekur të tjerat janë kompetencë e nivelit qendrorë

Alban Salihu, Gabim, është që nuk është prezent, drejtoresha e Drejtoratit për Shëndetësi. Pyetja e ime është për drejtoreshën e arsimit është aprovuar Rregullorja për Bursa qka ka ndodhë me këtë proces.

Albulena Kelmendi, kam pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë po më intereson ta di sa janë të infektuar stafi shëndetësor me këtë virus, sepse po zvogëlohet numri i punëtorëve e me zvogëlimin e punëtorëve punohet me reduktim të punëtorëve shëndetësor prandaj edhe shërbimet ndaj qytetarëve nuk munden me qenë në nivelin e duhur. Pyetja tjetër rreth parkingjeve pse ka tollovi nëpër trotuare, ka vetura të cilat pengojnë lëvizjen e qytetarëve. Lokalet tash janë duke punuar, mirëpo nuk jam e kënaqur fare sepse nuk respektohet distanca, inspektorët duhet të jenë shumë më aktiv sepse paguhen nga taksa e qytetarëve.

Lulzim Rustemi, kam dy pyetje qka u bë me pastrimin e shtratit të lumit Janjevka. Raporti publik për punën e Kuvendin Komunal të OJQ-së YAHR është shumë i gabuar dhe se kam vërejtje shumë në vlerësim sepse puna ka vazhduar dinamika e punës ka qenë në nivelin e duhur. Unë kam vërejtje publike për këtë raport sepse janë të dhëna jo të sakta.

Egzona Bytyqi, unë do t'i them disa fjalë lidhur me situatën me covid. 19. unë mund të ju informoj se qdo i dyti pacient vjen me simptome të kësaj sëmundje. Situata me covid është duke u keqësuar dhe vështirësuar dita ditës. Përkrahi kërkesat e Ukës që të shtohet numri i punëtorëve shëndetësor. Qerdhet janë të mbyllura, ka shqetësime të qytetarëve sepse janë të mbyllura dhe kërkohet që të hapen ato deri të hënen.

Ramiz Qeriqi, kam një ankesë për punëtorët e tatimit në pronë pse nuk janë hjek tatimet personave për objektet që janë ankuar. Mandej pyetja tjetër për lokalet rreth Kishes që nuk kanë mbishkrimet në gjuhen shqipe por vetëm në gjuhen serbe. Kam vërejtje te policija vet nuk e mbajnë distancën dhe nuk i mbajnë dorëzat ndërsa nga qytetarët kërkojnë mbajtjen e maskës.

Lumturije Bytyqi-Hasani, në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të ndihmohen familjet e prekura nga ky virus. Komuna duhet të bëjë pako emergjente për familjet e prekura nga covid 19 dhe se nëse janë hargjuar mjetet e ndara të ndahen prapë mjete.

Kryetari i Komunës, z.Imri Ahmeti në vazhdim ju përgjigj të gjitha pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Problemi me covid është shumë i madh dhe ka efekte në të gjitha poret e jetës,mendoj se me këtë duhet të dakordohemi të gjithë por mendoj se duhet lënë anash bërjen politik me këto probleme sepse nuk është mirë, duhet patur parasysh se edhe policia edhe inspektorët,punëtorët shëndetësor janë vëllezërit tonë dhe motrat tona.Sa i përket çështjes së taksave janë të nivelit qendror, unë e kam hjek një taksë komunale që ka qenë për kontroll shëndetësore.Mandej rreth pyetjes tjetër se a kemi kontaktuar të prekurit, neve kemi kontakte me të gjithë të prekurit dhe i kryejmë detyrat që janë obligim i yni,ne ju rrim hapur dhe përkrah atyre që janë të prekur dhe të gjithë qytetarëve.

Komuna ka destinu një automjet vetëm për çështje të covidit, pra vetëm për të prekurit nga sëmundja covid. Mandej sa i përket pranimi të stafit shtesë komuna nuk mundet me marr punëtorë kur t'i teket.Meqë e ka të kufizuar numrin e punëtorëve që mund t'i pranoi në punë. Sa i përket pyetjes rreth tatimit në pronë për mosëheqjen e tatimit për objektet për të cilat është bërë ankesë ato dërgohen në nivel qendror dhe ata i heqin nga tatimi.Për me qenë ma i kjart Vendimmarjen e ka në kompetencë niveli komunal ndërsa çështjen e fshirjes së tatimit e kanë niveli qendror. Qështja e hapjes së qerdheve është kërkesë me vend,sa i përket trotuareve me vend e parashtroi problemin Albulena, policia e trafikut duhet të mbajnë rregull më shumë.

Ukë Kryeziu,mirë që na dha përgjigje Kryetari,unë desha të them se duhet të ju bëjmë me dije nivelit qendror se duhet t'i heqin vetëm pagesat që kanë të bëjnë me covid.Të gjithë duhet të mos merremi me politikë por të mirremi me menagjim të situatës me pandeminë.

Egzona Bytyqi, unë nuk po ndjehem mirë sepse nuk jam ajo që kam kritikuar pa vend dhe gjithmonë kam pas kërkesa racionale.Kërkesa ime për staf është racionale dhe se askush nuk e dinë më mirë se unë nevojën për rritjen e stafit.

Ramiz Qeriqi, kryetar ke harru me ma dhënë përgjigjen për lokalet te kisha të kujt janë të Graqanicës apo të Lipjanit?

Kryetari i Komunës,z.Imri Ahmeti,Sa i përket pyetjes për lokalet të kisha, pyetja është shtruar gabimisht ,pyetja duhet të jetë a janë në teritorin e komunës së Lipjanit? Dhe unë po them se janë në teritorin e komunes tonë ndërsa nuk janë pronë e komunës por janë prona private.Sa i përket mbishkrimeve të emërtimeve të firmave të lokaleve te Kisha se a janë edhe në gjuhen shqipe nuk e dije por do të kërkoj që nëse nuk janë do të jenë edhe në gjuhen shqipe ose do t'i heqin krejt.Sa i përket pyetjes së Ukës njëherë u parashtroi ndryshe tani ndryshe sepse një kërkesë në nivelin qendror mund ta bëjmë për t'i liruar nga pagesa ndërsa neve si komunë nuk kemi të drejtë.

Kryesuesi, z.Daut Azemi, falenderoi, Kryetarin, për përgjigjet e dhëna dhe për gatishmërinë që çdo herë me qenë prezent nëpër mbledhje të Kuvendit.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

Kryesuesi i Kuvendit,z.Daut Azemi, sa i përket kësaj pikë kërkoj që ta shtyejmë për mbledhjen e radhës për shkak se punëtorët e sektorit të kuvendit nuk kanë qenë komplet arsyet janë infektimi me Covid dhe nuk ka qenë i kompletuar dhe duhet përmirësu, prandaj kërkoj që ekstraktet që t'i shtyejmë për aprovim në mbledhjen e ardhshme, kjo kërkesë unanimisht u aprovu dhe u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me këtë Raport, i cili është pjesë e këtij procesverballi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin

Lulzim Rrustemi, në raportin 3 mujor nuk kemi diskutuar por tash është raporti 6 mujor kemi edhe aprovimin e buxhetit, duhet ta diskutojmë dhe duhet thënë që ky raport është shumë shqetësues dhe se është larg shpenzimit, është shpenzim tejet i ulët pothuajse fillestar. Kemi shpenzim minimal të buxhetit. Te investimet kapitale nuk kanë filluar ende shpenzimet. Konsideroj që duhet të kemi dinamikë tjetër në shpenzimin e buxhetit meqë është shumë i vogël.

Shkelzen Bislimi, mendoj se shkaku i shpenzimit të ulët të buxhetit është pandemia dhe shpresoi që në të ardhmen të shpenzohet ky buxhet. Nuk kemi mundur të lëvizim e mos të flasim për investime kapitale. Pra është i arsyeshëm ky shpenzim i ulët i buxhetit.

Latif Ramadani, unë e përshkruaj këtë vit si të vështirë sa i përket hargjimit të këtij buxheti sidomos kur kemi parasysh faktin se deri në muajin maj nuk kemi patur aprovim të buxhetit. Duhet ta kemi parasysh pandeminë që nuk kemi mundur me pasë aktivitete, ky është një shpenzim real nuk ka asgjë që është hjesu apo modifiku por është paraqit gjendja reale sikur çdo herë. Shpresoj se do të arrihet të shpenzohet buxheti deri në fundvit.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati u kalua në pikën e tretë rendit të ditës

III

Propozim vendim për vënien në shqyrtim publik të projekt –dokumentit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2020-2028

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, tha se sot kemi me marr një vendim se a dëshirojmë apo nuk dëshirojmë me lejuar për me diskutu në shqyrtim publik në vazhdim i dha fjalën drejtoreshës dhe zyrtarës së DPUMM z. Hanushe Berisha të cilat në vazhdim elaboruan këtë pikë përmes sllajdeve.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, Hartat Zonale besoj që janë shumë të rëndësishme prandaj duhet të jenë në interes të qytetarëve, këtu mendoj në interes të të gjithë qytetarëve për qka nuk kam kurfar dyshimi në drejtoreshen për këtë.

Albulena Kelmendi, kam një lutje publike për të gjithë juve se nëse jeni testu duhet të jeni përgjegjës dhe të vetizoloheni. Shprehi indinjatën time që nuk kam pranuar materialin të cilin e prezntoi zyrtarja e që qenka kaq voluminoz. Pa e patur materialin neve nuk mundemi me bërë kurfarë analize prandaj kërkoi që sa më parë të na dërgohet materiali.

Kryesuesi, neve jemi në hapin e parë dhe më vonë do ta keni materialin dhe do të jepni komentet tuaja.

Ramiz Qeriqi, Pa e mbajtur, Kryetari apo Drejtoresha, një mbledhje me këta qytetar që janë te dera e sallës, lidhur me brengat e tyre dhe pa e pas materialin, unë do të jem kundër këtij vendimi.

Lulzim Rrustemi, Hartat kanë filluar të hartohen para 2 viteve dhe është thënë se do të ketë diskutime me qytetarë. Unë mendoj se duhet të na dërgohet materiali e pastaj të dërgohet në diskutim publik. Kjo pikë duhet të kthehet se pa material Kuvendi nuk mundet

me shqyrtu e as me marr vendim për këtë material aq voluminoz aq përmbajtësor e aq i rëndësishëm.

Drejtoresha e DPUMM-së, Emina Rexhiq, më vjen keq që nuk munda ti prezentoj vetë këto harta. Ne sot po votojmë vetëm që këto harta t'i kemi në dispozicion në vebfaqen e Komunës të diskutohen publikisht, nuk po aprovojmë harta zonale. Nëse sot e marrim këtë vendim neve do t'i kemi në vebfaqen e komunës dhe unë nga nesër do t'i pres qytetarët në zyrë dhe do të bisedojmë për brengat e tyre. Nuk është e vërtetë që nuk kemi pas debate publike dhe nuk është e vërtetë që nuk jemi konsultuar me qytetar.

Hyra Bytyqi, ne si grup parlamentar i LDK-së jemi për që ky Projekt-Dokument të aprovohet dhe të ecim më tutje. Falenderojmë "GIZIN" dhe drejtoreshën për këtë kontribut ndërsa shqetësimet e qytetarëve do të merren gjat muajit në vazhdimsi gjatë diskutimit publik. Edhe unë dëshiroi të sqaroj se ne sot me aprovimin e këtij vendimi për Hartat Zonale po vendosim vetëm për me i publikuar për diskutim publik për me biseduar me qytetar nuk po aprovojmë Harta Zonale.

Lulzim Rrustemi, është shumë e thjeshtë procedura nuk po përfillet sepse duhet ta kemi materialin dhe të shohim se çka është propozu bile për kësaj temë të ndjeshme edhe 1 muaj përpara dërgohet materiali.

Albulena Kelmendi, vlerësoi lartë punën e drejtoreshes mirëpo neve duhet ta kemi materialin ta shqyrtojmë atë dhe pastaj të votojmë.

Nënkryetari i Komunës, z. Fauz Xhemajli, u dhanë sqarime nga drejtoresha mendoj se ne jemi duke lëvizur hap pas hapi dhe tani jemi në fazën kur po kërkohet që këto harta të dërgohen në diskutim publik dhe pastaj mund të ketë ndryshime gjatë asaj kohe. Nuk po kërkohet kurfarë aprovimi por vetëm po kërkohet që të ipet mundësia me dalë në publik.

Afrim Miftari, shumë gjëra u thanë edhe nga parafolësit por mendoj se thelbi i këtij vendimi është që të ipet mundësia të gjithëve që pas publikimit për shqyrtim publik të ipen vërejtje. Tubimet me qytetar do të jenë sfidë për shkak të pandemisë dhe duhet të punohet që të aprovohet ky Dokument me rëndësi të madhe.

Lulzim Rrustemi, kam një replikë nënkryetari nuk duhet të përkrah shkeljet ligjore sepse nuk duhet të votohet një vendim jo ligjor.

Kryesuesi, është tjetërkush që e përcakton se a është ligjor apo jo, nuk jeni ju.

Kryesuesi i dha fjalën prapë Nënkryetarit i cili tha se nuk është qëllimi të replikoj por dua të them se jemi në përputhje me ligjin sepse sot jemi duke aprovu vetëm vënjen në diskutim publik.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 15 votat për, 8 kundër dhe 2 apstenime aprovoi këtë:

VENDIM

PËR TRAJTIMIN E PARCELËS KADASTRALE P-71409044-01745-0 NË PROCESIN E SHQYRTIMIT PUBLIK DHE FINALIZIMIT TË DOKUMENTIT TE ARDHSHEM TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR- HARTA ZONALE E KOMUNËS SE LIPJANIT

I. Anullohet Vendimi 15Nr.463-12519 i datës 28.02.2020 për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0, konform Shkresës përcjellëse të MAPL-së 020-199/4 të datës 06.07.2020 mbi Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit dhe Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr.2842/20 të datës 22.06.2020.

II. Obligohet, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi konform dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe rekomandimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të zhvillojë procedurat ligjore për finalizimin e dokumentit të planifikimit -Harta Zonale të Komunës

ndërsa parcela kadastrale P-71409044-01745-0 në Zonën Kadastrale Lipjan në vendin e quajtur "Varosh" të trajtohet dhe përfshihet si pjese e zonës gjatë procesit të shqyrtimit publik të Hartës Zonale të Komunes dhe miratimit të dokumenteve të ardhshme të planifikimit hapësinor, konform kushteve zhvillimore të percaktuara në Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit

III. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë; Vendimi.

Kuvendi shkoi në pauzë deri në orën 14,00

Pas pauzës, Kuvendi vazhdoi punën me pikën e katërt të rendit të ditës

IV

Propozim vendim paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit dhe kërkoj aprovimin e tij.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, është mirë që Komuna të jep në shfrytëzim pronat me qëllim të zhvillimit ekonomik por komuna përmes komisioneve duhet t'i mbikqyrë dhe të kërkojë nga investitorët të zhvillojnë projektet dhe të kanë parasyshë investimet dhe punësimin sa më të madhë.

Shkëlzen Bislimi, prona e komunës duhet të shfrytëzohet sa më mirë por duhet të konsultohemi me banorët vendor dhe të mirret pëlqimi i tyre sepse po dështojmë me investitorë.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjinden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-4	Babush i Muhaxherëve	16132
2	P.Sh.Kuvendi	P-71409059-00555-	Babush i	3868

	Komunal Lipjan	2	Muhaxherëv e	
--	----------------	---	-----------------	--

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale ipen në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet Njoftimit publik. Pronat e cekura në nenin 1 të këtij vendimi janë publikuar brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Kryetarit të Komunës 1Nr.463-62822 datë 18.09.2019 konformë dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 si prona të lira për dhënien në shfrytëzim.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është investimi në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Procedurën e Njoftimit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi

V

Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit i dha fjalën drejtorit Bekim Shabani DzhE i cili tha se për të vazhduar punën duhet të caktohet komisioni i cili duhet të ndjekë procedurat ligjore lidhur me dhënien në shfrytëzim të këtyre parcelave dhe prej ekzekutivit janë

caktuar Bekim Shabani dhe Nazim Gashi si dhe nga shoqëria civile Deniz Gashi,ndërsa nga Kuvendi duhet të caktohen edhe dy anëtarë tjerë.

Alban Salihu,pyeti drejtorin dhe kërkojë sqarime; të dijë se kush është ky anëtar nga OJQ-të sepse për qdo herë po na vjen i njëjti emër.

Ramiz Qeriqi,edhe unë kam të njëjtën pyetje sepse gjithherë është i njëjti emër.

Bekim Shabani,sa i përket OJQ-së sipas ligjeve në fuqi OJQ-të duhet të jenë më aktive dhe të bijnë propozimet e tyre,ndërsa Deniz Gashi është nga OJQ-ja Vizioni Rinorë Janjevë.

Afrim Miftari,pyeti se cila është detyra e komisionit,a është që t'i caktojë kriteret dhe kushtet për dhënien në shfrytëzim të tokës apo kuvendi duhet të vendos për këtë qështje.

Lulzim Rustemi,edhe unë desha të ngriti këtë qështje sepse duhet të ndërrohet anëtari nga shoqëri civile sepse ka edhe OJQ tjera në komunën tonë.

Nehat Tërpeza,LDK-ja për anëtar të komisionit nga radhët e veta propozoj Majlinda Sylejmanin.

Argjend Tasholli,PDK-ja për anëtar të komisionit nga radhët e veta propozoj Nazmi Krasniqi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 25 votat për, 4 apstenime aprovoi këtë

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-32604 i datës 30.07.2020(në vazhdim të tekstit: Komisioni) formohet në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
- 2.Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
- 3.Majlinda Sylejmani nga subjektet politike
- 4.Nazmi Krasniqi nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 463-32604 të datës 30.07.2020.

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dipozitave tjera të akteve nënligjore që do të derivojnë nga Ligji.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë; Vendimi

VI

Propozim vendim për trajtimin e parceles kadastrale P-71409044-01745-0 në procesin e shqyrtimit publik dhe finalizimin e dokumentit të ardhshëm të planifikimit hapsinor Harta Zonale e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i'a dha fjalën drejtoreshës, Emina Rexhiq, e cila në vazhdim arsyetoi këtë propozim Vendim dhe arsyet se përse duhet të merret një Vendim i tillë.

Kresuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, ne edhe kur është marrë ky vendim kemi thënë se ka shkelje ligjore dhe kjo po del e vërtetë pasi që Ministria përkatëse e ka kthyer, andaj ne nuk do të votojmë këtë propozim Vendim.

Kryesuesi në vazhdim i tregoj arsyet se përse është vonuar Ministria përkatëse rreth përgjigjes për këtë Vendim dhe theksoi se kuvendi ka vendos në bazë të urdhëresave nga kjo Ministri lidhur me vendosjen për këtë parcelë dhe ne nuk kemi dashtë të vonohemi për arsye se pronari ka kërkuar që ta shfrytëzoi pronën e vetë, ndërsa

Ministria tash po kërkon që këtë pronë ta shqyrtojmë me Hartat Zonale që do të aprovohen në kuvend.

Shkëlzen Bislimi, puna e kësaj parcele është bërë si puna e xhamisë së Llugaxhisë, ne në kuvend kemi votuar që pronarit t'i ipet e drejta e ndërtimit në parcelën e vet.

Nehat Tërpeza, ne si grup e kemi shqyrtar këtë problematik dhe kemi marrë një vendim që kemi menduar që është zgjidhur ky problem por siqë po shihet ministria e ka kthyer mbrapa, kështu që tash po kërkohet nga ne që kjo parcelë të inkorporohet dhe të shqyrtohet gjatë hartimit të Hartave Zonale.

Ramiz Qeriqi, mua po më duket si lojë politike dhe si duket pronari ka gjetur miq në qeveri dhe po dëshiron përfitime më të mëdha.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 16 votat për, 1 kundër dhe 6 apstenime aprovoi këtë

VENDIM

PËR TRAJTIMIN E PARCELËS KADASTRALE P-71409044-01745-0 NË PROCESIN E SHQYRTIMIT PUBLIK DHE FINALIZIMIT TË DOKUMENTIT TE ARDHSHEM TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR- HARTA ZONALE E KOMUNËS SE LIPJANIT

I. Anulohet Vendimi 15Nr.463-12519 i datës 28.02.2020 për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0 ,konform Shkresës përcjellëse të MAPL-së 020-199/4 të datës 06.07.2020 mbi Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit dhe Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr.2842/20 të datës 22.06.2020.

II. Obligohet, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi konform dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe rekomandimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të zhvillojë procedurat ligjore për finalizimin e dokumentit të planifikimit -Harta Zonale të Komunës

ndërsa parcela kadastrale P-71409044-01745-0 në Zonën Kadastrale Lipjan në vendin e quajtur "Varosh" të trajtohet dhe përfshihet si pjese e zonës gjatë procesit të shqyrtimit publik të Hartës Zonale të Komunes dhe miratimit të dokumenteve të ardhshme të planifikimit hapësinor, konform kushteve zhvillimore të percaktuara në Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit

III. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë;Vendimi

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Naser Bytyqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi